



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 28, datë 26 / 05 /2022

PËR
DHËNIEN E TITULLIT “PROFESOR EMERITUS”
PROF. HAMIDE STINGA

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republikën e Shqipërisë” neni 3, 38, 61, VKM Nr.112, datë 23/02/2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, Kreu i V-të (Dispozita të fundit dhe kalimtare) pika 2, Statutin të UART (Funksionet e Senatit Akademik të UART) neni 24, gërma ff, si dhe në propozimin e Fakultetit të Muzikës me anë të shkresës me Nr. 197 Prot. datë 23.05.2022, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Të japë titullin “**Profesor emeritus**” për Prof. **Hamide Stringa**.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Erlind FUSHA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



nr. 1050 Prot
26/05/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI

Nr. 1991 Prot.

Tiranë, më 26.05.2022

Lënda: Mbi vlerësimin për titullin “Profesor Emeritues” të Prof. Hamide Stringa

Drejtuar : Prof. Kastriot Çausi
Rektor i UART

Bashkëngjitur po ju dërgojmë vlerësimin për titullin “Profesor Emeritues” të Prof. Hamide Stringa.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



Me respekt

Prof. Dr. Isak Shehu

Dekan i Fakultetit të Muzikës
Universiteti i Arteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP**

Nr. 199 prot.

Tiranë, më 20.05.2022

Lënda: Mbi dhënien e titullit “Profesor Emeritus” Prof. Hamide Stringa

**Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Muzikës
Prof. Dr. Isak Shehu
Universiteti i Arteve
Sheshi Nënë Tereza**

I nderuar z. Shehu

Nisur nga aktivitetet e shumta që po zhvillohen për të kremtuar 60 vjetorin e themelimit të Fakultetit të Muzikës, Njësia Bazë KMDP dëshiron të vlerësojë dhe të shprehë mirënjohjen ndaj stafit akademik, tashmë të dalë në pension, i cili përfaqëson vlera të veçanta përsa i përket kontributit institucionalo-pedagogjik, artistik dhe atij shkencor.

Lidhur me sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Neni 61. pika 5, propozojmë vlerësimin me titullin “Profesor Emeritus” të Prof. Hamide Stringa.

Prof. Stringa konsiderohet si një ndër personalitetet e spikatura sidomos përsa i përket kontributit pedagogjik e atij shkencor. E diplomuar në Konservatorin “Çajkovskij” në Moskë, znj. Stringa nis aktivitetin e saj artistik si këngëtare soliste pranë Teatrit të Operas dhe Baletit për të kaluar më pas, me çeljen e Konservatorit Shtetëror të Tiranës (1962), pedagoge pranë këtij institucioni.





Gjatë karrierës së saj Prof. Hamide Stringa ka kryer edhe funksione drejtuese institucionale sikurse si sekretare për muzikën në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, sikurse dhe Shëfë katedre pranë Institutit të Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve).

Përpos karrierës artistike, Prof. Stringa është evidentuar për kontributin e saj shkencor nëpërmjet botimeve universitare dhe atyre shkencore.

Në cilësinë e pedagoges së Historisë së Muzikës, pranë ILA, ajo realizon botimin e parë të teksteve për lëndën e Historisë së Muzikës Botërore. Teskti i prof. Hamide Stringës u strukturua në 4 vëllime duke nisur prej muzikës në lashtësi (Egjypt, Babiloni etj) e deri tek Romantizmi dhe më pas shkollat kombëtare. Teksti i Historisë së Muzikës Botërore të Prof. Hamide Stringës ka qenë teksti bazë i lëndës së Historisë së Muzikës me të cilin janë formuar artistët e të gjithë specialiteteve të diplomuar në institucionin e vetëm të arsimit të lartë artistik në Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi kontributi shkencor i Prof. Hamide Stringës materializohet edhe në botime të tjera si monografia “Një jetë mbi tastierë” kushtuar veprimtarisë së pianistes së parë shqiptare Lola Gjoka, “Shtigje dhe hapësira” dedikuar rrugëtimit artistik të sopranos Jorgjie Filçe (Truja) etj.

Po kaq i rëndësishëm është kontributi pedagogjik i Prof. Hamide Stringës i shtrirë në një periudhë mbi 48 vjeçare. Panvarësisht detyrave të tjera që ju ngarkuan, sikurse është rasti i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, znj. Stringa nuk u shkëput asnjëherë nga përgjegjësia e mësimdhënies dhe edukimi i brezit të ri. Përgjatë karrierës pedagogjike Prof. Stringa dha kontributin e saj në lëndën e historisë së muzikës, kantos speciale, muzikologjisë speciale, muzikës së dhomës (për specialitetin e kantos) dhe klasës së operas.

Për gjithë sa më sipër, dëshirojmë të propozojmë vlerësimin e Prof. Hamide Stringa me titullin “Profesor Emeritus” me motivacionin “Për kontributin e shquar në formimin e brezave të artistëve të rinj pranë Fakultetit të Muzikës dhe veprimtarinë shkencore”

Prof. Asoc. Dorian Çene

Përgjegjës i Njësisë Bazë KMDP





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI

Nr. 197 Prot.

Tiranë, më 23.05.2022

Lënda: Propozime për dhënie titulli “Emeritus” dhe “Mirënjohje”

**Drejtuar: SENATIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE
Prof. KASTRIOT ÇAUSHI**

Bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, dekanati i Fakultetit të Muzikës në mbledhjen e datës 05 Maj 2022, në prani të Prof. Asoc. Merita Rexha (Tërshana), Prof. Arben Llozi, Prof. Asoc. Dorian Çene, si dhe Prof. Asoc. Dr. Kastriot Tusha, pasi diskutuaun për dhënien e titujve “Emeritus”; si dhe “Mirënjohje” i propozojnë Senatit Akademik të Universitetit të Arteve dhënien e titujve si më poshtë:

Titullin “Emeritus” t’i jepet

1. Prof. Margarita Kristidhi (Milkani);
2. Prof. Hamide Stringa;

“Mirënjohje” t’u jepet

1. Fatos Jaho
2. Andrea Canaj
3. Kristofor Qorri
4. Edison Misso
5. Dia Laro
6. Muharrem Denisi
7. Haig Zacharian
8. Gjon Simoni
9. Zef Çoba
10. Agim Duro



11. Suzana Frashëri
12. Gaqo Çako
13. Suzana Turku

FAKULTETI I MUZIKËS

DEKANI

Prof. Dr. Isak SHEHU

